



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1594/6 prot.

Datë 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 820/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mero Oil” SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ SHA në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-81505-04-09-2026, me objekt: “*Loti 1: Naftë*”, me fond limit 31,533,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce, me adresë: Rr. “28 Nëntori”, nr.1, Lgj.7, Korçë, Kodi Postar 7001

Ankimues: Operatori ekonomik “Olsi” SHPK me NUIS J63423463I dhe adresë: Nr. Pasurie 68/3, Zona Kadastrale Nr.2890 , Griz, Fier

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Mero Oil” SHPK me NUIS M44506003B dhe adresë: Lagjja e Re, Zona Kadastrale 8562, numer pasurie 5/1273, Korce.

Operatori ekonomik “Europetrol Durrës Albania” SHA me NUIS K24010212N dhe adresë: Njesia Nr. 2, Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 5, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10-04-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-81505-04-09-2026, me objekt: “*Loti 1: Naftë*”, me fond limit 31,533,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.

II.2. Në datën 13.05.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

- | | |
|------------------------------------|------------------------|
| 1. “Europetrol Durrës Albania” SHA | 5.99 lekë, kualifikuar |
| 2. “Mero Oil” SHPK | 7.50 lekë, kualifikuar |
| 3. “Olsi” SHPK | 8.40 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 20.05.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 22.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6699, protokolluar me nr.1594/2026 prot, datë 22.05.2026, i operatorit ekonomik “Olsi” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-81505-04-09-2026, me objekt: “*Loti 1: Naftë*”, me fond limit 31,533,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mero Oil” SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania” SHA në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Pasi jemi njohur me vlerësimin e procedurës së prokurimit kërkojmë skualifikimin e operatoreve ekonomik MERO OIL shpk dhe EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.a për arsye si më poshtë vijon:

Shoqëria jonë kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik MERO OIL shpk, për mospërbushje të kriterëve të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik MERO OIL shpk sh.p.k. nuk ka plotësuar saktë dhe në mënyrë të plotë të dhënat e kërkuara nga dokumentet e tenderit, Shtojca nr. 9 Formulari i Vetëdeklarimit. Ky operator nuk ka plotësuar në përputhje me parashikimet e nenit 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të VKM nr.285/2021, i ndryshuar, duke cenuar vlefshmërinë e këtij dokumenti si provë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar përcaktohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Në pikën 2 dhe 3 të nenin 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, parashikohet se:

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, a në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrjnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund t'aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Ky formular, në kuptim të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, funksionon si një provë paraprake zëvendësuese e dokumentacionit justifikues, çka nënkupton se vlefshmëria e tij është e kushtëzuar nga plotësia, saktësia dhe verifikueshmëria e informacionit të deklaruar.

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nuk ka karakter thjesht formal, por përbën një element thelbësor mbi të cilin mbështetet vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të kualifikimit nga operatorët ekonomikë.

Në të njëjtën linjë, dispozitat e nenit 26 të VKM nr. 285/2021 përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detyrueshme përmbajtjen e këtij formulari, duke parashikuar një listë elementesh që kanë karakter kumulativ dhe që lidhen drejtpërdrejt me kriteret e kualifikimit të parashikuara në nenin 77 të ligjit.

Për rrjedhojë, çdo mungesë apo pasaktësi në deklaratimet e kërkuara nuk mund të konsiderohet si një mangësi formale, por përbën një cenim substancial të procesit të verifikimit, duke e bërë të pamundur për autoritetin kontraktor të konstatojë në mënyrë të sigurt përmbushjen e kriterëve ligjore nga operatori ekonomik.

Operatori ekonomik MERO OIL shpk nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e saktë të plotësuar të formularit të Vetëdeklarimit.

Një formular i paplotë nuk mund të prodhojë efektin juridik të provës paraprake për kualifikim, ndërsa një formular që përmban pasaktësi cenon besueshmërinë e deklaratimeve dhe krijon pasiguri juridike mbi statusin dhe kapacitetet e operatorit ekonomik. Po kështu, një formular i paraqitur në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi duhet të konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm për qëllime vlerësimi.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë pjesën II Shkaqet e përjashtimit në pikën A: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacion dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për të gjitha rubrikat që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Në përfundim, referuar sa me sipër, operatori MERO OIL sh.p.k. nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, gjë kjo në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe ato të dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, ky operator ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9. Nuk ka provuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe oferta e tij duhet të konsiderohet e pavlefshme dhe duhet të skualifikohet.

Praktika të njëjtë ka pasur e Komisioni i Prokurimit Publik si V E N D I M Nr.521/2026 datë 21.04.2026.

Sa më sipër, operatori MERO OIL sh.p.k duhet të s'kualifikohet nga procedura e prokurimit.

Shoqëria jonë gjithashtu kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.a, për mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Së pari, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k. pas njoftimit si fitues, nuk provon gjendjen faktike të tij në momentin e dorëzimit të ofertës, duke qenë se një pjesë e dokumenteve rezultojnë të lëshuara pas këtij momenti.

Së dyti, nuk plotëson pikën e liceses 2.4 mbi kriterin ku Ofertuesi duhet të jete i licensua për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre , i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Për sa me sipër duhet të paraqese: Autorizim për ushtrim aktiviteti Tregeti me pakice të lendeve djegëse Karburante ose Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lëshuar nga Bashkia Korçë.

Operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k. nuk ka plotësuar saktë dhe të plotë të dhënat e kërkuara nga dokumentet e tenderit, Shtojca nr. 9 Formulari i Vetëdeklarimit. Kemi bindjen nuk është plotësuar në përputhje me parashikimet e nenit 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të VKM nr.285/2021, i ndryshuar, duke cenuar vlefshmërinë e këtij dokumenti si provë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, pas njoftimit si fitues, pasi nuk provon gjendjen faktike të tij në momentin e dorëzimit të ofertës, duke qenë se një pjesë e dokumenteve rezultojnë të lëshuara pas këtij momenti.

Në shtojcën 9 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit pika 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit , autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në shtojcën 9 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, Shkaqet e përjashtimit, Pika A Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, parashikohet :

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit t? posaç?m n? rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen

e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Informacioni i pasqyruar në formularin e vet?deklarimit, gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund t? aksesoj? direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Në nenin 76 Kriteret detyruese për skualifikim të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja ç , të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën b të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet

hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

Referuar legjislacionit mbi procedurat e prokurimit publik parashikohet se Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k, duhet të dorëzonte pranë autoritetit kontraktor vec dokumentacionit Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, pranë autoritetit kontraktor ndër të tjera dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat a , b , d , dh , e , h , i dhe j , të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm dokumente, bashkë me dokumente të tjera shoqëruese të ofertës dhe dokumentacionin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k duhej të dorëzoj gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve me datë lëshimi para hapjes së ofertave dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumentacionin e cituar me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se data 11.05.2026.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. Dokumentacioni provuese të parashikuara në shkronjën a , b , d , dh , e , h , i dhe j , të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, të paraqitura si provë e deklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim më datë të mëvonshme nga data e

hapjes së ofertave nuk provon gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore e rregullatore në fuqi për prokurimin publik dhe si rrjedhim nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Pra, sa më sipër, operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k nuk ka plotësuar paragrafin 5 të pikes 6 të nenit 26 - Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, në kundërshtim kjo me VKM- se nr 285/2021, i ndryshuar, në të cilin thuhet: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat a , b , d , dh , e , h , i dhe j të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Dokumentet provuese, që paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij OE ? ku operatori ekonomik EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k, në momentin e kerkuar, ka paraqitur dokumenta të cilat nuk provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Dokumentat e paraqitura nga ana e këtij OE, si psh: vertetim për gjendjen gjyqësore për subjektin administratorin dhe ortaket, vertetimin për pagesën e taksave dhe tatimeve, vertetimin për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vertetim për pagesën e energjisë elektrike, etj, janë dokumenta të datave pas dates së ofertimit, pra në kundërshtim me kërkesën e mesipërme të VKM-se dhe DST .

Sa më sipër, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin jashtë afatit të përcaktuar dhe për këtë arsye nuk plotëson kriteret e kualifikimit dhe duhet të s'kualifikohet.

Vendime të ngjashme ka ndjekur e Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin V E N D I M Nr. 594/2026 datë 06.05.2026.

Së dyti, nuk plotëson piken e liceses 2.4 mbi kriterin ku Ofertuesi duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre , i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

Në kriterin e vecante të kualifikimit pika 2.4 parashikohet se:

2.4 Ofertuesi duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre , i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Për sa më sipër duhet të paraqesë: Autorizim për ushtrim aktiviteti Tregti me pakice të lendeve djegëse Karburante ose Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm naftës për automjet,vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë të leshuar nga Bashkia Korçë.

Bazuar në argumentimin në lidhje me këtë kriter në DST është përcaktuar se:

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik , nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik , Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 Për përpunimin,

transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre të ndryshuar me Ligjin Nr. 9218, datë 08.04.2004 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 Për perpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre të ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

Ne nenin 11 të ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE , i ndryshuar përcaktohet: Personat juridikë, që i nështrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:

- a) rafineri naftë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit të naftës bruto;
- b) naftësjellës e gazsjellës, që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës bruto dhe të gazit natyror (kategoria O);
- b/1) impiante të përpunimit;
- c) shoqëritë e tregtimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre dhe lëndëve që shërbejnë si lëndë djegëse;
- ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante për automjete;
- d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Ne nenin 15, pika të ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE , i ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet:

Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante, ku përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, kryhet nga stacionet e shitjes së karburanteve. Me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregtohen vetëm nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasisë së shitjes.

Stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante ndalohen të mbushin bombola me gaz të lëngshëm për përdorim shtëpiak apo tregtar. Stacionet e shitjes së karburanteve janë persona juridikë, që themelohen në një nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni tregtar. Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me Licencën përkatëse, sipas këtij ligji, me kusht që ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria.

Ne nenin 20 te ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE , i ndryshuar percaktohet:

1. Licencat u jepen personave juridikë, të parashikuar në pikat ç dhe d , të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse).

2. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat ç dhe d të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Referuar edhe objektit historik të veprimtarisë së kësaj shoqërie file:///C:/Users/User/Downloads/ekstrakt_historik_2026-05-18T13-52-01-062Z.pdf, nuk rezulton qe kjo shoqëri të ketë veprimtari në tregtimin e karburanteve në Bashkinë Korçë si rrjedhim nuk dëshmon të jete i licencuar per ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimit.

Pra, operatori ekonomik nuk ploteson kriterin per Autorizim per ushtrim aktiviteti Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante ose Licence per tregtimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet,vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatorët fundore te leshuar nga Bashkia Korçë. , dhe per kete arsye duhet te s`kualifikohet.

Sa më sipër, shoqëria jonë kërkon s`kualifikimin e opertoreve ekonomik MERO OIL sh.p.k dhe EUROPETROL DURRES ALBANIA sh.p.k, pasi nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit në këtë procedurë prokurimi.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1594/1 Prot., datë 25.05.2026.

II.6. Në datën 01.06.2026 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr.1594/2 prot., Vendimi i KSHA-së nr. 809 prot., datë 01/06.2026 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Olsi” SHPK. Referuar këtij vendimi rezulton se KSHA-ja ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues. Në datën 02.06.2026 është protokolluar në KPP me nr. 1594/3 prot., dokumentacionin përkatës që autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesit.

II.7.Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Olsi” SHPK se: *“Shoqëria jonë kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik MERO OIL shpk, për mospërbushje të kriterëve të kualifikimit, si më poshtë vijon:*

Operatori ekonomik MERO OIL shpk sh.p.k. nuk ka plotësuar saktë dhe në mënyrë të plotë të dhënat e kërkuara nga dokumentet e tenderit, Shtojca nr. 9 Formulari i Vetëdeklarimit.

Ky operator nuk ka plotësuar në përputhje me parashikimet e nenit 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të VKM nr.285/2021, i ndryshuar, duke cenuar vlefshmërinë e këtij dokumenti si provë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar përcaktohet se:

- 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
- 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

Në piken 2 dhe 3 te nenin 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, parashikohet se:

2. *Formulari permbledhes i vetedeklarimit permban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, a në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetedeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Ky formular, në kuptim të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, funksionon si një provë paraprake zëvendësuese e dokumentacionit justifikues, çka nënkupton se vlefshmëria e tij është e kushtëzuar nga plotësia, saktësia dhe verifikueshmëria e informacionit të deklaruar.

Formulari përmbledhës i vetedeklarimit nuk ka karakter thjesht formal, por përbën një element thelbësor mbi të cilin mbështetet vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të kualifikimit nga operatorët ekonomikë.

Në të njëjtën linjë, dispozitat e nenit 26 të VKM nr. 285/2021 përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detyrueshme përmbajtjen e këtij formulari, duke parashikuar një listë elementesh që kanë karakter kumulativ dhe që lidhen drejtpërdrejt me kriteret e kualifikimit të parashikuara në nenin 77 të ligjit.

Për rrjedhojë, çdo mungesë apo pasaktësi në deklaratimet e kërkuara nuk mund të konsiderohet si një mangësi formale, por përbën një cenim substancial të procesit të verifikimit, duke e bërë të pamundur për autoritetin kontraktor të konstatojë në mënyrë të sigurt përmbushjen e kriterëve ligjore nga operatori ekonomik.

Operatori ekonomik MERO OIL shpk nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për paraqitjen e saktë të plotësuar të formularit të Vetedeklarimit.

Një formular i paplotë nuk mund të prodhojë efektin juridik të provës paraprake për kualifikim, ndërsa një formular që përmban pasaktësi cenon besueshmërinë e deklaratimeve dhe krijon pasiguri juridike mbi statusin dhe kapacitetet e operatorit ekonomik. Po kështu, një formular i paraqitur në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi duhet të konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm për qëllime vlerësimi.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë pjesën II Shkaqet e përjashtimit në pikën A: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacion dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për të gjitha rubrikat që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Në përfundim, referuar sa me sipër, operatori MERO OIL sh.p.k nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetedeklarimit, gjë kjo në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe ato të dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, ky operator ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës 9. Nuk

ka provuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe oferta e tij duhet të konsiderohet e pavlefshme dhe duhet të skualifikohet. Praktika të njëjtë ka pasur e Komisioni i Prokurimit Publik si V E N D I M Nr.521/2026 datë 21.04.2026. Sa më sipër, operatori MERO OIL sh.p.k duhet të s'kualifikohet nga procedura e prokurimit", Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankimin elektronik, të administruar me nr. A/2026/6699, protokolluar me nr.1594/2026 prot, datë 22.05.2026,, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve nga operatorit ekonomik "Mero Oil" SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshme të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 48, "Kushtet formale të ankesës", pika 3:

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni".

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "Mero Oil" SHPK. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "Olsi" SHPK se: operatori ekonomik "Europetrol Durres Albania" SHA nuk plotëson piken e liceses 2.4 mbi kriterin ku Ofertuesi duhet te jete i licensuar per ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi ne perputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre , i ndryshuar dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Per sa me siper duhet te paraqese: Autorizim per ushtrim aktiviteti Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante ose Licence per tregetimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet,vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatorët fundore te leshuar nga Bashkia Korçë", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim", pika 2.3 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3 Ofertuesi duhet te jete i licensuar per ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi ne perputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Per sa me siper duhet te paraqese : Autorizim per ushtrim aktiviteti "Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante" ose Licence per tregetimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet,vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatorët fundore" te leshuar nga Bashkia Korçë.

Argumentimi: "Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 "Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e nënprodukteve të tyre" të ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se jane te licencuar per ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

III.2.2. Në shtojcën 9 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", Pjesa I: "Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik", Gërma B, e dokumentave standarde të tenderit, është përcaktuar se:

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

III.2.3. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik "Europetrol Durrës Albania" SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 9, Formular përmbledhës i vetëdeklarimit, i plotësuar nga operatori ekonomik "Europetrol Durrës Albania" sh.a, ku rezulton se, në pikën B "Deklaratë për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik "Europetrol Durrës Albania" sh.a, nuk ka deklaruar operatorin ekonomik "Skenderi G" SHPK si subjekt në kapacitetin e të cilit do të mbështetet, dhe konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	"Europetrol Durres Albania"sha
Numri NIPT/et:	K24010212N
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Bulevardi "Zhan D'Ark pall5,1/1 Tirane 1001
Përfaqësuesi (emri):	Frident Kuqi
Telefoni:	+355 069 _____ / 065 _____
E-mail:	e _____ @yahoo.com pa@europetrolalbania.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit	NIPT –i	Përqindja e	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to
------------------------	---------	-------------	------------------------------------

të propozuar		nënkontraktimit	për t'u nënkontraktuar
N/A	N/A	N/A	N/A

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
N/A	N/A	N/A	N/A

- Licencë e subjektit “Europetrol Durrës Albania” SHPK me nr. LN-4902-04-2012 me kod VIII.1.A, me kategori: “Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi I produkteve dhe/ose lëndëve a pajosjeve të tjera me rrezikshëri”, nënkategori: “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: “Tregtim me shumicë:benzinë kat II/A, gasoil kat.III/A, naftë bruto kat.0/A, solar kat.IV/B, bitum kat.V/A, mazut kat.V/B, III/Ç Lëndë djegëse përdorimi termik civil dhe/ose industrial”.
- Deklaratë, lëshuar nga shoqëria “Europetrol Durrës Albania” SHPK, me përmbajtjen si vijon:

Shoqëria “Europetrol Durres Albania” sh.a garanton realizimin e plote te sasise se kerkuar nga ju . Jemi dakort me kerkesat tuaja .

Operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania” sh.a deklaron:

Disponojme distributore me deklarate noteriale me (LOGO ,, Eida ,, ,,Skenderi G ,,)

Deklarojme se ju sherbejme ne gjithë qarqet e Shqipërisë me karta e tollona :

- *Marrim përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike te personalizuar me targen e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, me Karte dhe me Tollona sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.*
- *Operatori ekonomik mbulon furnizimin nepermjet kartave elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Antoriteti Kontraktor.*
- *Bazuar ne VKM Nr.561 datë 29.07.2016 'Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qevcrisjes së përgjithshëm“. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës ju ofrojmë një faqe menaxhimi II karburanteve (ëeb page), ku furnizimi dhe shpenzimi i liarburantit për mjetet efektive të Transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.*
- *Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) ofron shërbimin e ngarkimit U sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit, si dhe administrimi i sasisë se karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti kontraktor.*
- *Sasia e lengut qe ka karta ose tolloni jane te vlefshme derisa te perfundojnë pa afat skadence.*

Në Korce me Deklaraten e shoqërisë “Skenderi G” disponojme Dy pika: Ne Qytet dhe nje ne Dishnicë.

Per sa me siper deklarojme garantojme realizimin e plote ne te gjitha deklarimet.

- Deklaratë noteriale nr.rep 1022, nr.kol 491, datë 25.09.2025, me objekt: “Deklarim për dhënie në përdorim të pikave të karburantit”, anë të së cilës, deklaruesit: shoqëria “Skënderi G” SHPK dhe shoqëria “Europetrol Durrës Albania” SHPK deklarojnë me vullnet të lirë si më poshtë vijon:

“Unë S.K, si përfaqësus ligjor i shoqërisë “SKENDERI-G” shpk dhe unë F. K si përfaqësus ligjor i shoqërisë “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” sha, deklarojmë nën përgjegjësinë personale dhe ligjore, duke njohur dhe pranuar pasojat e plota ligjore që sjell një deklariim i pa vërtetë dhe të qartë, për vërtetësinë e tij deklarojme se:

- Për furnizimin e shitjes së karburanteve me pakice, me shërbim 24 ore, me tollon ose lëng, të gjitha me pistolete publike, në të gjithë territorin e Shqipërisë, në stacionet e furnizimit të shitjes së karburanteve, shoqëria “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” sha, do të marr në përdorim nga shoqëria “SKENDERI-G” shpk, pa afat të gjitha pikat e karburanteve të mëposhtme të cilat janë të pasqyruara e të regjistruara në QKB, në Ekstraktin e regjistrimit e Tregtar, të shoqërisë “SKENDERI-G” shpk.

-Shoqëria “SKENDERI-G” shpk në të gjitha pikat e saj do ti shërbeje shoqërise “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” sha per klientet e saj te tenderave e te tjera rue tollona e karte elektronike. Ky sherbim do te ofrohet për 24 orë pa problem.

Ne kemi rënë plotësisht dakort që këto pika do të shërbejnë pa afat, për pranimin e tollonave me shërbim 24 ore non stop, klientëve të shoqërisë “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” sha.,” bashkëngjitur lista e pikave të shërbimit me adresat përkatëse, ku rezultojnë të përfshira edhe stacionet e shitjes së karburantit në Korçë, me adresa: Korçë, Rr. “Midhi Kostani”, Nr.15; Korçë-Dishnicë-Korçë dhe Korçë-Cerave Leshnice, Fshati Leshnjcë ZK 2420.

- Licencë “Për tregtimin me pakicë të karburanteve gazit të lëngshëm të naftës për automjet vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë”, me Nr.4325/1 prot., datë 16.05.2025, lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, për subjektin “Skënderi G” SHPK, me adresë: Korçë, Lagja nr.9, Rr. “Midhi Kostani”, Nr.15.*
- Licencë “Për tregtimin me pakicë të karburanteve gazit të lëngshëm të naftës për automjet vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë”, me Nr.4324/1 prot., datë 16.05.2025, lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, për subjektin “Skënderi G” SHPK, me adresë: Korçë, Rruga Korçë-Bilisht, Km 1, Fshati Dishnicë*

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.7. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.9. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.”.

III.2.10. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.11. Në vendimin e KSHA-së nr.809 prot., datë 01.06.2026 rezulton se ky pretendim i ankimesit është refuzuar si më poshtë vijon:

“Në lidhje me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues, sipas të cilit operatori ekonomik “EUROPETROL DURRES ALBANIA” sh.a. nuk plotëson pikën 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me licencimin për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur Licencën me Nr. LN-4902-04-2012, Kodi VIII.1. A kategoria “Prodhim, depozitim, transport, përdorim dhe /ose tregëtim i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri” në emer të EUROPETROL DURRËS ALBANIA SHA me Nipt. K24010212N, dhe 2 (dy) licencat e pikave të furnizimit të subjektit Skenderi G shpk: License Nr. 4325/1 prot. datë 16/05/2025 “Për Tregëtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet Vajra lubifikantë për përdorim nga konsumatorët fundore”, dhe Licensen me Nr. 4324/1, datë 29/05/2025, “Për Tregëtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet Vajra lubifikantë për përdorim nga konsumatorët fundore”.

Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur Deklaratën Noteriale Nr.1022 Rep., Nr.491 Kol., datë 25.09.2025, Kontratën e Furnizimit, datë 01.03.2024, si dhe licencat e pikave të furnizimit të subjektit “SKENDERI-G” sh.p.k., të cilat janë vënë në dispozicion për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Nga përmbajtja e deklaratës noteriale rezulton se ndërmjet palëve është krijuar një marrëdhënie juridike e vlefshme, sipas së cilës subjekti “SKENDERI-G” sh.p.k. ka vënë në dispozicion të operatorit ekonomik pikat e tij të tregtimit me pakicë të karburanteve, për furnizimin e klientëve të këtij të fundit në kuadër të kontratave publike (tendera), duke garantuar funksionimin e shërbimit në mënyrë të vazhdueshme, pa kufizime dhe paafat. Komisioni vëren se pika 2.4 e Dokumentave Standarte të Tenderit - Kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që operatori ekonomik të provojë ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi dhe disponueshmërinë e kapaciteteve të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuptim, nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se operatori ekonomik ka provuar si licencimin për ushtrimin e aktivitetit sipas legjislacionit, ashtu edhe disponueshmërinë faktike dhe juridike të pikave të furnizimit në territorin e Bashkisë Korçë. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “EUROPETROL DURRES ALBANIA” sh.a. ka përmbushur kërkesat e pikës 2.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe pretendimi nuk qëndron. Për sa më lart pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë.”

III.2.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton

kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.13. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik, konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht, se për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin

82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

Në ofertën e paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ SHA, nuk e përmbush kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi nga ana e tij nuk provohet të jetë i licencuar për trejetimin me pakice të karburanteve, gazit të lëngshëm naftes për automjet, vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë” të leshuar nga Bashkia Korçë apo të ketë paraqitur Autorizim për ushtrim aktiviteti “Trejetimi me pakice të lendeve djegëse Karburante”, të leshuar nga Bashkia Korçë. Nga ana tjetër konstatohet se operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ SHA ka paraqitur shtojcën 9, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku rezulton se, nga ana e tij, në pikën B “Deklaratë për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ sh.a, nuk është deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e operatorin ekonomik “Skenderi G” SHPK lidhur me plotësimin e kërkesës së sipërcituar.

Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në rastin konkret operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ sh.a nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit asnjë subjekt mbështetës lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë. Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik,

i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ SHA në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Olsi” SHPK, për kualifikimin e padrejtë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania“ SHA në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi ankimuesi nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshon gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Olsi” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-81505-04-09-2026, me objekt: “Loti 1: Naftë”, me fond limit 31,533,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Europetrol Durres Albania” SHA dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit në SPE, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Olsi” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

